



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2021:270700

Datë: 16.12.2024

Numri i dokumentit: 06601399

**P.nr. 576/2021**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Gjilan – dega Viti**, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani në çështjen penale ndaj të pandehurës E.L., me vendbanim në Viti, rruga e “Tiranës”, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1927/2021, të datës 30.11.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik me datë 10.12.2024, në të njëjtën datë, në mungesë të palëve, mori dhe publikisht shpalli, kurse me datë 16.12.2024, përpiloi me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

E pandehura E.L., nga babai K., nëna Xh., e lindur Sahiti, e lindur me datë 27.11.1999, në fshatin Begracë, Komuna Kaqanik, me vendbanim në Viti, rruga e “Tiranës”, e pa martuar, nënë e 1 (një) fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, e punësuar, e gjendjes së varfër ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, me numër personal 1244074363.

### **Ë S H T Ë F A J T O R E**

Sepse, me datën 30.10.2021, rreth orës 00:14 minuta, në Viti, te shkolla fillore “D.K.”, e pandehura E.L. së bashku me të miturën E.H, me dashje dhe qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete ka kryer vjedhje në dëm të dëmtuarës- Shkollës “D.K.”, ashtu që të njëjtat kishin shkuar me automjetin “Pikap”, me ngjyrë të Gjelbër dhe kishin ngarkuar rreth gjysmë metra dru për ngrohje të cilët dru më herët i kishin qitë jashtë rrethojave të shkollës dhe për derisa kishin qenë duke i ngarkuar drutë i kishin vërejtur policinë dhe të njëjtat kishin ikur nga vendi i ngjarjes.

-me këtë ka kryer veprën penale, vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura, e në bazë të nenit 4, 70, 71, 81 dhe 82 të KPK-së, dhe nenit 242 paragrafi 2 dhe neni 364 të KPRK-së, të pandehurës i shqipton:

## VËREJTJE GJYQËSORE

Ashtu që të pandehurës E.L., i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprë penale për të cilën nëse ajo sërish kryen veprë të tillë gjykata do t'i shqiptojë një sanksion më të rëndë penal.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës, shkolla fillore "D.K.", në Viti, nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Obligohet, e pandehura që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 € (njëzet euro), dhe 20 € (njëzet euro) për viktimat e krimit konform nenit 39 paragrafi 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave, në afat prej 15 ditësh nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së aktgjykimit me kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

#### 1. Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 01.12.2021, në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën me numër PP.II.nr.1927/2021, të datës 30.11.2021, ndaj të pandehurës E.L., me vendbanim në Viti, rruga e "Tiranës", për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 10.12.2024, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën ish-in prezent prokurori i shtetit Flamur Ahmeti dhe e pandehura E.L.. E pandehura pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet.

#### 2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se e pandehura e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pranimi i fajësisë nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza edhe atë: raporti fillestar i incidentit me numër 2021-ÇG-421, i datës 30.10.2021, deklarata e të pandehurës, E.L., deklarata e të Miturës E.H, deklarata e dëshmitarëve Rrahim Qazimi dhe Bafti Bekiri, vërtetim mbi sekuestrimin e automjetit, forma e kthimit, e datës 01.11.2021, forma e kthimit të sendeve – dru për djegie, e datës 09.11.2021, ekstrakti i lindjes të të miturës E.H, fotografi nga vendi i ngjarjes, raporti i oficerit Granit Halimi, i datës 30.10.2021, si dhe shkresat e tjera në lëndë dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

#### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se e pandehura Edrimonda Luzha ka kryer veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 242, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPRK-së, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës dhe të njëjtës ti shqiptohet vërejtja gjyqësore ngase duke i marrë parasysh të gjitha

rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ky sanksion do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Gjykata me rastin shqiptimit të këtij sanksioni ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë, duke u bazuar në nenet 69,70 dhe 71 të KPRK-së, ashtuqë rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se e pandehura ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, e njëjta është penduar dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, se drunjtë e vjedhur i ka kthyer sërish tek e dëmtuara, faktin se e pandehura për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, ngase gjykata nuk ka pasur prova se e njëjta është recidiviste përkatësisht përsëritëse e veprave penale, gjendjen e varfër ekonomike, nënë vetushqyese, ndërsa si rrethanë rëndësuese gjykata mori parasysh rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo vepër penale, dashjen dhe vendosmërinë e të pandehurës për të kryer veprën penale, vepra penale është kryer në oborrin e institucionit shkollor, faktin se veprën penale e ka kryer me përgatitje paraprake, në atë mënyrë që drunjtë paraprakisht i ka hedhur (bashkë me të miturën H.H.), jashtë rrethojave të oborrit të shkollës, kurse më vonë me automatën “pikap”, kanë shkuar dhe i kanë marrë. Andaj, mbi të lartcekurat gjykata konsideron se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurës të lartcekur, duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës.

**5. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurës dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar**

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurës duke i marrë parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë së saj. Gjykata, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së.

**6. Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike**

Gjykata duke u bazuar në nenin 460 të KPPRK-së, nuk e ka udhëzuar të dëmtuarën në kontest civil, pasi përfaqësuesi i saj-drejtori, nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

**7. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurës, gjykata, duke u bazuar në nenin 449 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurën ta obligojë ti paguajë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës, paushallin gjyqësor në shumë prej 20€, në afat prej 15 ditëve pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata konform nenit 364 paragrafi 1 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjilan– dega Viti  
Departamenti i përgjithshëm  
P.nr. 576/2021, me datë 16.12.2024**

**Gjyqtarja e vetme gjyquese,  
Blerina Jakupi Ramadani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.